



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

-Shërbimi i Kuvendit-
01Nr. 060/03-12154/19
Kaçanik, 30.04.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (Katërt)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 30 Prill 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë - të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtori i drejtoreve: Diana Reka, Fatmir Loku, Ukshin Qallaku dhe Festim Neziraj, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Qlirim Troni, Iliriana Berisha dhe Fatlume Guri-Selimi.

Nga OSBE, mbledhja u monitorua nga, Faruk Dërmaku.

Mbledhja u monitorua përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfiye Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, e konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër. Pjesëmarrës në mbledhje janë, 27 anëtarë-të gjithë anëtarët e KK, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi Mbledhjen e IV të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 30 Prill, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Tre Mujor Financiar, për periudhën: Janar - Mars 2019;
3. Propozim Vendimi për transferin e mijeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe Mëditje;
4. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të Parcelave Kadastrale me numër: 00231-0; 00232-0, ZK në Bob në emër të Mefail Faik Zeneli nga f. Bob dhe Parcelsa Kadastrale Nr. 00230-0, ZK Bob, në emër të Milaim Ramadan Zeneli nga f. Bob, për ndërtimin-rregullimin e infrastrukturës së sportit në f. Bob;
5. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00561-3, Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës I (Parë), në emër të Ekrem Krraba nga f. Soponicë;
6. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00047-0, Zona Kadastrale Kovaçec, me

kulturë, Arë e klasës 3 (Tretë), në emër të Xhemil Burrniku dhe Faruk Burrniku nga f. Kovaçec;

7. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00751-0, Zona Kadastrale Nikaj, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Gani Guri nga f. Nikaj;
8. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 02166-21, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Muhamet Baftiri nga f. Dubravë;
9. Raporti i Komisionit të Ankesave për përgjedhjen e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara; dhe
10. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal, të Komunës së Kaçanikut me Komunën e Hanit të Elezit, në fushën e infrastrukturës rrugore në viset rurale.

Për dy pikët e fundit, Kryesuesi i Kuvendit, kërkoj falje që materiali iu ka ardhur me vonesë, ndërkaq lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçiku, Dy pikët e fundit, kërkoj të votohen ndaras për me hyrë në rend pune.

Kryesuesi i Kuvendit. Atëherë Pikën e 9-të e shtroj në votim për aprovim për me hyrë në rend pune; Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Konstatoj së pika 9 u vendos njëzëri me hyrë në rend pune në këtë mbledhje. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit e shtroj në votim për aprovim edhe Pikën e 10 për me hyrë në rend pune; Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Konstatoj së pika 10 u vendos njëzëri me hyrë në rend pune në këtë mbledhje.

Atëherë, Rendin e propozuar të punës prej 10 pikëve, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e Punës në përbërje prej 10 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbal i mbledhjes së III-të (Tretë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri me një vërejte të vogël të diskutimi i Nazife Krasniqi, e cila vërejtje do të korrigohet nga Shërbimi i Kuvendit dhe Procesverbal i mbledhjes së III-të (Tretë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës përvendet e përmirësuar. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e III-të (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës përvendet e përmirësuar. / Lënda: 01Nr. 060/01-8615/19.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikën e dytë, kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Shpend Krusha, Në Lagjen ,Imishti, në rrugën “Ilirët”, shtyllat e energjisë elektrike janë vendosur të betonit, ndërkaq nuk janë bërë ende lidhjet e rrymës në këto shtylla. Rryma është ende e kyçur në shtyllat ekzistuese të drurit. Unë nuk e di nëse mund të paraqesin rrezik shtyllat e vendosura që nuk janë lidhur me rrymën.

z. Ekrem Kyçyku, Në një Konkurs punësimi të shpallur në QKMF, është kërkuar që kandidatët të cilët kanë aplikuar të pajisen me Certifikatë shëndetësorë. Nuk e di a është e ligjshme me ua kërkuar certifikatën shëndetësore, sepse është e kushtueshme (20-25€) për kandidatët të cilët kanë aplikuar për me marrë pjesë në një konkurs.

znj. Lirije Luta, Kërkoj që të mbrohen Pyjet e Komunës së Kaçanikut, e në veçanti me datën 1 Maj në Ditën ndërkombëtare të punëtorëve, ashtu që inspektorët të inspektojnë në f. Strazhë, në mënyrë që të ndalojnë ndezjen e zjarreve në atë pjesë.

z. Adnan Reka, Për Drejtoren e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural, të ‘Livadhet e Shtrazës’ Para disa ditësh pasqë një objekt si lloj depoje me mbishkrin ‘Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural’ Objekti ishte shumë i mirë dhe gati i përfunduar, por ende pa përfunduar kishte filluar të shkatërrohet. Cili është qëllimi dhe fati i këtij investimi nga kjo Ministrin?

znj. Fatijona Kyçyku, Parashtroj pyetje, Kur do të filloj realizimi i projektit të ndërtimit të Qarshisë së qytetit të Kaçanikut? Nëse ky projekt nuk ka filluar ende, Kërkesa ime është që të fillohet sivjet me realizimin e këtij projekti.

znj. Kaltrina Tafili, Në Lagjen Teneq të f. Stagovë, kërkoj të bëhet rregullimi i rrjetit të energjisë elektrike, sepse për shkak të defekteve në rrjetë, qytetarëve të kësaj lagjeje po iu shkatërrohen pajisjet elektrike të amvisërisë. Gjithashtu në këtë lagje mungojnë; Asfaltimi dhe Ndriçimi publik.

z. Bekim Koxha,

1. Malet e Sharrit janë duke u shkatërruar. Arsyetimi i cili na është dhënë nga DBPZHR është i pamjaftueshëm. Kjo dukuri duhet të ndalet sa më parë, sepse pyjet e komunës tonë po shkatërrohen më të madhe. Kjo çështje është shqetësuese dhe duhet marrë masa emergjente për mbrojtjen e pyjeve të komunës tonë.
2. Në f. Shtrazë, një objekt i cili u ndërtua të pishat e Shtrazës, më intereson të di a ka leje ndërtimi ai objekt?
3. Më intereson të di, Përse nuk janë bërë ende kyçjet në rrjetin e ujësjellësit të f. Koxhaj.

z. Selim Reka,

1. E kam një Kërkesë të qytetarëve të Kaçanikut, që komuna me ndaluar ndërtimin në zonat e hapësirave gjelbëruese në qytet.
2. Në Rrugën, “Asim Vokshi” kanë ngelë 100m rrugë pa u asfaltuar. Është mirë që të asfaltohet sipërfaqja e mbetur e rrugës, kur dihet së me këtë rrugë lidhet rruga të Axhamët dhe të Senatoriumi.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kërkesa të tjera, përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës, atëherë procedojmë me pikët e radhës të rendit të punës:

2. Raporti Tre Mujor Financiar, për periudhën: Janar - Mars 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka në këtë raport finansiar, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Nga Raporti finansiar, shihet se shpenzimet kanë shënuar ulje në këtë tre mujor krahasuar me tremujorin e vitit paraprak, ndërkaq nëse shkohet me këtë trend të shpenzimeve buxhetore, atëherë do të kemi më tepër bartje të mjeteve buxhetore më tepër sesa në vitet tjera. Të HVK shihet së është e ulët përqindja e realizimit të tyre dhe nëse shkohet me këtë trend, atëherë është vështirë me u realizuar Plani i buxhetit te të HVK në vitin 2019. Nëse i shkojmë të hyrat sipas sektorëve, atëherë shihet së 0 (zero) të HVK janë nga inspektorati. Këtë shqetësim e kemi shprehur disa herë në mbledhje, ndërkaq është koha e fundit që inspektorët duhet me marrë veprime të nevojshme e më punuar në këtë drejtim. Të Tatimi në Tokë, edhe në këtë program buxhetor, shihet se nuk ka mjete të inkasuar. Të Alokimi i mjeteve buxhetore, ky pozicion është mirë, sepse ka mjete buxhetore të alokuara. Të shpenzimet komunale, nga raporti shihet se janë ngritur shpenzimet komunale të uji, mbeturinat dhe të energjia elektrike.

z. Adnan Reka, Duke e shikuar këtë raport finansiar pashë se Komuna nga të HV planifikon te arkëtoj 1000 € vetëm nga taksa e fotokopjes, ndërsa për 3 muaj ka realizuar 143€. Mua vërtetë më vjen keq për të gjithë ata qytetarë që vijnë të marrin shërbime në Komunë, ata shumicën e rasteve vijnë të nxjerrin ndonjë dokument për të cilin duhet të paguajnë, por t'i ngarkoni edhe me fotokopje të dokumentit për të cilët ka nevojë administrata komunale është vërtet shqetësuese. Meqë po e ofroni edhe këtë shërbim, Unë ju pyes, a keni punësuar ndonjë ‘zyrtar të lartë për fotokopje’?

Dhe e dyta, tani nga Ekrem Kyçyku e kuptova, pse drejtoria e Shëndetësisë paska arkëtuar 1730€ vetëm për 3 muaj nga taksa për, Certifikata mjekësore, sepse po shitkan certifikata mjekësore pa u kontrolluar fare nga mjekë përkatës. 100 aplikues që kanë paguar nga 15€ për certifikata mjekësore në “Konkursin për mami” që ishte para disa javësh, paskan paguar 1500€ dhe konkursi është anuluar. Qenka mirë t'i përsërisni konkurset sa më shpesh që komuna të realizoni sa më shumë para nga të HV.

znj. Nazife Krasniqi, Të inkasimi i mjeteve buxhetore, krahasuar me vitin e kaluar, del një ngritje e vogël e realizimit. Të Sektori, Buxhet dhe Financa, shihet se inkaismi të Tatimi në Pronë ka shënuar ulje, ndërkaq ende nuk kemi të hyra nga Tatimi në Tokë. Gjobat nga inspektorati janë 0 (zero) të hyra. Të DUKMM, të hyrat nga Taksat për Leje ndërtimi janë më të vogla, ndërkaq të DBPZHR vetëm nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore, shihet së janë inkasuar mbi 6 mijë euro, ndërkaq nga shitja e masës drusore nuk ka të hyra. Të shëndetësia nuk ka gjoba nga inspektorati, janë vetëm një shumë diku 95 €. Të hyrat direkte të gjobat në trafik ka pasur pak me tepër të hyra buxhetore në këtë periudhë. Të Projektet kapitale, projekti me Nr. 22, Ndërtimi i kanalizimeve fekale, janë paraparë mjete, ndërkaq nuk dihet se në cilat vende kanë me u ndërtuar këto kanalizime.

Edhe të projekti, Ndriçimi publik, nuk është cekur lagjja apo vendbanimi se ku ka me u realizuar ky projekt. Gjithashtu nuk është përcaktuar, Ndërtimi i parqeve publike. Të Projekti i zhvillimit të bujqësisë, janë paraparë mjete buxhetore, ndërkaq nuk di nëse është realizuar ky projekt.

z. Ekrem Raka, Nga raporti finansiar shihet së, shpenzimet e telefonisë fiksë janë rritur 100%, ndërkaq ato të telefonisë mobile janë rritur mbi 100%. Unë kujtoj se është një rritje e shumë e madhe e shpenzimeve për telefoni fiksë dhe atyre mobile, nëse nuk janë rritur tarifat e këtyre shërbimeve komunale.

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Drejtori i Financave nuk është prezent në mbledhje për me na dhënë sqarime të nevojshme në këtë raport finansiar, kështu që po mundohem me dhënë unë sqarime të nevojshme. Sa i përket shpenzimit të buxhetit, dihet se nuk mund të jetë të mëdha shpenzimet buxhetore për Investime Kapitale në tremujorin e parë të vitit

buxhetor për shkak të kohës, ndërkaq buxheti i komunës i vitiit 2019 nuk ka shqetësimë për mos realizimin e tij. Këtë vit ka qenë shqetësim, Tatimi në pronë për shkak të procedurave, mirëpo është vazhduar afati. Qytetarët e komunës veç kanë filluar me i marrë faturat. Të projektet të cilat u potencuan; ndriçimi publik dhe kanalizimet, projektet janë një vjeçare, ndërkaq do të intervenohet sipas nevojave, si të ndriçimi publik, ashtu që ku të përfundon qyteti, do të vazhdohet me fshatra. Të projektet e kanalizimeve, do të intervenohet sipas nevojave që paraqiten.

Kryesuesi i Kuvendit, Të projektet të cilat janë l vjeçare, është mirë me participuar edhe komunitetet, ashtu si po veprojmë ne komuniteti, Doganaj në shumë projekte.

z. Ramadush Osmani, Të projektet e kanalizimit dhe ato të ndriçimit publik, procedurat e prokurimit kodohen si projekte të përbashkëta, ndërkaq të njëjtat precizohen me një vendim.

Kryetari i Komunës, Të telefonia fiksë dhe telefonia mobile, nuk ka ndryshim të tarifave, sigurisht janë rritur shpenzimet nëse është paguar ndonjë faturë me vonesë e vitiit paraprak.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, Raporti finansiar nuk del në votim, kështu që konstatoj se, **Kuvendi i Komunës u Njoftu me Raportin Tre Mujor Financiar, për periudhën: Janar - Mars 2019.**

3. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitiit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe Mëditje;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë pikë, fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Sqaroj për mjetet buxhetore të cilat do të transferohen, programet dhe arsyet e transferimit të mjeteve buxhetore. Arsyetimi është, shtimi i stafit të Zyra e Kryetarit të Komunës, kështu që për me ua krijuar pagat dhe mëditjet e këtyre punëtorëve, është dashur të transferohen mjetet nga programet tjera buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Komuna jonë edhe ashtu është të themi, kampion, për të shpenzuar buxhetin për, Paga dhe Mëditje, duke i marrë mjetet nga të gjitha kategoritë tjera buxhetore. Ndërsa punësimet i bënë me kriterin, të fala nga ministria dhe me preferanca politiko-partiake duke mos përfillur aspak profesionalizmin përfusha përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicë votash Për, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV, Abstenoj, Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së, Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transferim e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitiit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe Mëditje.

4. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të Parcelave Kadastrale me numër: 00231-0; 00232-0, ZK në Bob në emër të Mefail Faik Zeneli nga f. Bob dhe

Parcela Kadastrale Nr. 00230-0, ZK Bob, në emër të Milaim Ramadan Zeneli nga f. Bob, për ndërtimin-rregullimin e infrastrukturës së sportit në f. Bob;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj së bëhet fjalë për disa prona të stadiumi- të fushat ndihmëse. Një marrëveshje ka qenë në vitin 2002 për ndërrimin e pronave, por e njëjtë nuk është realizuar, kështu e kemi pa të arsyeshme dhe të nevojshme me bërë shpronësimin e atyre pronave dhe me u rregulluar kjo çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit të DUKMM, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Me shikuar në gjeoportal, gjysma e shtëpisë dhe oborrit të Mefail Zeneli, është në pronë komunale.

z. Ukshin Qallaku, Ne i kemi hyrë në parcelë të Mefail Zenelit, ndërkaq gjeoportali nuk janë të sakta, shtëpia e Mefailit nuk është në pronë komunale.

Kryesuesi i Kuvendit, Matjet kadastrale janë më të sakët sesa gjeoportalet. Një Marrëveshje me pronarë të atyre pronave që kërkojen me i shpronësuar, veç e ka bërë paraprakisht, Kryetari i Komunës.

z. Bekim Koxha, A parashihen këto shpronësime me PZHK dhe me Harta Zonale?

z. Ukshin Qallaku, Me PZHK ajo pjesë ka qenë stadium, ndërkaq çështja e shpronësimit nuk parashihet me PZHK. Nëse dikush ka mundësi me arritur marrëveshje për këmbim pronave, lë të urdhëroj, sepse me rregulluar këtë çështje duhet ose përmes shpronësimit ose përmes këmbimit të pronave.

z. Adnan Reka, Përse nuk është shqyrtuar kjo situatë para se me u ndërtua fusha ndihmëse në atë pjesë të parcelës.

Kryetari i Komunës, Fusha sportive ka filluar në vitin 2011, ndërkaq tani jemi në një situatë ku pronarët e atyre pronave po tentojnë me na e ndryshuar gjendjen në atë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV, Abstenime nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të Parcelave Kadastrale me numër: 00231-0; 00232-0, ZK në Bob në emër të Mefail Faik Zeneli nga f. Bob dhe Parcela Kadastrale Nr. 00230-0, ZK Bob, në emër të Milaim Ramadan Zeneli nga f. Bob, për ndërtimin-rregullimin e infrastrukturës së sportit në f. Bob.

5. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00561-3, Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës I (Parë), në emër të Ekrem Krraba nga f. Soponicë;

Për këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, Më intereson të di, ku gjendet kjo parcelë, a është e paraparë me plane urbanistike dhe me harta zonale me u bërë ndërtimë në atë parcelë? Nëse jemi duke i hartuar Planin Zhvillimor të Komunës dhe Planin Urbanistik, atëherë përsë nuk presim deri sa të miratohen këto plane të reja zhvillimore e urbanistike?

z. Ekrem Kyçku, Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore thuhet se, Ndërrimi i destinimit të tokave bujqësore të klasave 1-4, bëhet pas marrjes së Pëlqimit paraprakisht nga pala, ndërkaq ne nuk e kemi një pëlqim të tillë nga pala paraprakisht.

z. Ukshin Qallaku, Ne mund të mos bëjmë ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore, mirëpo në zona urbane ku ka të ndërtimë, mundet të bëhet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Në afërsi të këtij lokacioni ku kërkohet me iu ndërruar destinimi, është i ndërtuar një objekt i cili është me leje ndërtimore dhe ajo pjesë me herët ka qenë zonë ndërtimore.

z. Bekim Koxha, Sa po e shoh unë, ne po bimë në kundërshtim me vetën tonë, sepse po bëjmë ndërrim destinimi pa Plane Zhvillimore të Komunës dhe pa Harta Zonale.

Kryesuesi i Kuvendit, Ne e dimë së vendbanimet dita ditës po rritën, ndërkaq sipas ligjit në fuqi, nëse në një vendbanim ka ndërtimë, atëherë lejohet ndërrimi i destinimit të pronave bujqësore në atë pjesë në toka ndërtimore.

z. Bekim Koxha, Objektet rreth magjistrales, më intereson të di; A kanë leje ndërtimi dhe sa metra është e lejuar me ligj të janë afér rrugës (magjistrales) ndërtimet?

z. Ukshin Qallaku, Të gjitha ndërtimet përreth magjistrales kanë leje ndërtimi, ndërkaq lejen e ndërtimit e marrin nga ministria e jo nga komuna.

z. Bekim Koxha, Të, Fusha e Manit, dihet se para pak kohe ndodhi një tragjedi, ku humbën jetën 2 persona, ndërkaq në atë lokacion është grumbulluar stoqe zalli, ndërkaq inspektorët nuk po intervenojnë me marrë veprime të nevojshme me i gjobitur ata persona që kanë grumbulluar stoqe zalli (rërë) në atë lokacion.

Kryesuesi i Kuvendit, Të objektet përreth magjistrales, lejet e ndërtimit palët i marrin nga ministria e jo nga komuna.

zpj. Nazife Krasniqi, Në këtë vit shihet se ka me pak leje ndërtimi të lëshuara, ndërkaq në anën tjetër kemi më tepër ndërrim të destinimit të tokave bujqësore në toka ndërtimore. Kjo u pa nga mjetet e grumbulluara për ndërrim destinimi të tokave bujqësore. Më intereson të di, Ku janë arsyet që leje ndërtimore ka me pak sesa ndërrime të destinimit të tokave bujqësore në ato ndërtimore?

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 6 anëtarë, Abstenuan 7 anëtarë. Prezent në mbledhje kur u votua kjo pikë ishin 26 anëtarë. I anëtar nuk ishte në sallë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00561-3, Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës I-r (Parë), në emër të Ekrem Krraba nga f. Soponicë.

6. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00047-0, Zona Kadastrale Kovaçec, me kulturë, Arë e klasës 3 (Tretë), në emër të Xhemil Burrniku dhe Faruk Burrniku nga f. Kovaçec;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me 13 votë Për, Kundër ishin 4 anëtarë, Abstenuan 8 anëtarë, ndërkaq 2 anëtarë nuk ishin në sallë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00047-0, Zona Kadastrale Kovaçec, me kulturë, Arë e klasës 3 (Tretë), në emër të Xhemil Burrniku dhe Faruk Burrniku nga f. Kovaçec.

7. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00751-0, Zona Kadastrale Nikaj, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Gani Guri nga f. Nikaj;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Unë po abstenoj në Propozim Vendimet Paraprake për ndërrimin e destinimeve të tokave bujqësore në ato ndërtimore, për arsyen së, nuk po e di se a janë të ligjshme apo jo këto ndërrime të destinimeve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me 13 votë Për, Kundër ishin 5 anëtarë, Abstenuan, 7 anëtarë, 2 anëtarë nuk ishin në sallë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00751-0, Zona Kadastrale Nikaj, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Gani Guri nga f. Nikaj.

8. Propozim Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 02166-21, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Muhamet Baftiri nga f. Dubravë;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin për këtë pikë:

z. Besim Vishi, Si do të veprohej në rast së ka kërkesa për ndërtimin e objekteve 7-8 katërshe në atë lokacion në të cilin po kërkohet me iu ndërruar destinimi?

Kryesuesi i Kuvendit, Çështja e ndërtimeve është e rregulluar me Ligjin për ndërtimin. Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me 15 votë Për, Kundër ishin 6 anëtarë, Abstenuan 6. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 02166-21, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Muhamet Baftiri nga f. Dubravë.

9. Raporti i Komisionit të Ankesave për përgjedhjen e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara:

Kryesuesi i Kuvendit, Raporti ka ardhur pak me vonesë, edhe pse Adnani e ka dërguar me herët, por për shkak të disa problemeve teknike, nuk kemi pasur mundësi me dërguar kur është dërguar materiali tjetër. Fjalën e ka kryetari i komisionit të Ankesave, Adnan Reka.

z. Adnan Reka, Jo për shkak të komisionit, por siç u tha edhe nga Kryesuesi i Kuvendit ishin disa probleme teknike që është vonuar raporti, unë nuk do ta zgjas shumë meqë raportin e keni para vetës dhe shpresoj që e keni lexuar, si kryesues i këtij komisioni unë jam i hapur për pyetjet e juaja nëse keni në lidhje me këtë raport.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Nëse miratohet ky Raport i Komisionit të Ankesave, a duhet të formohet Paneli i ri përgjedhës, apo do të vazhdon punën Paneli ekzistues përgjedhës ?

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse e anulojmë Konkursin dhe e Rishpallim Konkursin e ri, atëherë duhet të ndërrohet edhe Paneli përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara.

z. Selim Reka, Unë kisha kërkuar të na jap pak sqarime edhe Kryetari i Panelit përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara. Festim Neziraj.

z. Festim Neziraj, Ideja pse nuk i kemi intervistuar kandidatët aplikant me shkrim, ka qenë me i shkurtuar pak procedurat. A kemi vepruar mirë apo jo atë e ka vlerësuar komisioni i ankesave. Unë pajtohem me të gjeturat nga Komisioni i Ankesave dhe jam me u përsëritur procedurat e konkursit.

Kryesuesi i Kuvendit, Paneli përgjedhës duhet të jetë i ri, Konkursi duhet të Rishpallet, ndërkaq testimi të jetë edhe me shkrim, sepse formës së testimit me shkrim nuk mund t'i ikim. Pra a jeni të pajtimit që të anulohet Konkursi paraprak, Të Shpallet Konkursi i ri dhe të formohet Paneli i ri përgjedhës.

z. Kaltrina Tafili, Unë pajtohem me të gjeturat e komisionit të ankesave, por jo edhe me Ankesat e kandidateve. Të përgjedhja e kandidatëve, nuk ka ndonjë parregullsi, me përjashtim të kandidates Fiknete Krasniqi e cila është në lidhje familjare me anëtaren e komisionit Elmihane Krasniqi, mirëpo në këtë rast Elmihani është tërhequr nga vlerësimi për shkak të konfliktit të interesit, përndryshe anëtarët e përgjedhur të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara janë gjithëpërfshirës të subjekteve politike.

Kryesuesi i Kuvendit, Ankesat janë pse nuk është mbajtur testi me shkrim, testimit me shkrim nuk guxojmë t'i ikim dhe është dashur të ruhen formularët e vlerësimit. Kandidatët të cilët kanë aplikuar, nuk do të kenë nevojë të ri-aplikojnë. Nëse nuk ka kush diçka, e shtroj në votim propozimet të cilat i potencova për përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, si vijon:

- 1.Të Anulohet Konkursi për përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ
2. Të Rishpallet Konkursi për përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ
3. Të formohet Paneli i ri Përgjedhës për përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ
Të gjitha këto propozime që i potencova do të bëhen me një vendim.

Rezultati i votimit ishte, “Për” ishin të gjithë anëtarët e KK me përashtim të, Arlinda Rakoci-Raka e cila Abstenoj.

Paneli i ri përgjedhës do të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve, 3 anëtarë do të propozohen nga tri subjektet politike me të mëdha të KK, ndërkaq 1 anëtarë nga ekzekutivi i Komunës dhe 1 anëtarë nga OJQ. Atëherë, shkojmë me propozime konkrete për 3 anëtarët të panelit përgjedhës nga KK nga 3 subjektet politike me të mëdha.

Nga PDK, z. Nexhat Loku e propozoj për anëtar paneli, Kadri Krivenjeva,

Nga LVV, Ekrem Kyçyku e propozoj për anëtar paneli, Shpend Krusha.

Nga LDK, Selim Reka e propozoj për anëtar paneli, Besnik Salihu.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan njëzëri.

Atëherë në saje të rezultateve të votimit, del konstatimi së, Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

- 1.Anulimin e Konkursit për përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara;**
- 2. Rishpallje të Konkursit për përgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara;**
- 3. Formimin e Panelit të ri përgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, në përbërje:**

1. Kadri Krivenjeva, PDK,
2. Shpend Krusha, LVV, dhe
3. Besnik Salihu, LDK,
4. anëtar nga Ekzekutivi i Komunës dhe
5. anëtar nga shoqëria civile.

10. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal, Komunës së Kaçanikut me Komunën e Hanit të Elezit, në fushën e infrastrukturës rrugore në viset rurale;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Sqaroj për Nismën për bashkëpunim ndër komunal me Hanin e Elezit, ndërkaq shtoj së qëllimi është fushën e infrastrukturës rrugore në viset rurale, përkatësisht për realizimin e Projektit për rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës, nga fshati Gorancë deri në fshatin Kotlinë.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, Prioritetet dihen, ndërkaq a po kemi të drejtë ne si komunë me aplikuar për grantet qeveritare, nëse nuk bëhem i pjesë e kësaj marrëveshje, por bëhem i pjesë e ndonjë marrëveshje tjeter ndër komunale me një komunë tjeter, siç është fjala vjen Ferizaj.

Kryetari i Komunës, Ne si komunë kemi të drejtë me aplikuar për grante, por për sivjet ka përfunduar afati për me aplikuar. Nëse nuk kalon kjo iniciativë, atëherë nuk mund të aplikojmë për grante për marrëveshje ndër komunale. Njëjtë është nëse komuna e Hanit të Elezit nuk bëhet partnere me ne, atëherë nuk mund të përfitojmë grantin për projektin e paraparë.

Kryesuesi i Kuvendit, Projekti është që lidhet me atë komunë, kjo është arsyja që do të hymë në partneritet me këtë komunë, ndërkaq kjo nuk na pengon që komuna jonë në të ardhmen më hyrë në partneritet me ndonjë komunë tjetër.

z. Bekim Koxha, Mua me duket se është neglizhencë e Ekzekutivit të Komunës, sepse një projekt i cili e lidhë komunën tonë i cili ka pasur mundësi të realizohet me bashkëpunim ndër komunal është; Ndërtimi i rrugës së vjetër, Kaçanik- Shkup.

z. Shpend Krusha, Sa kishim me pasur mundësi me lidhur ndonjë marrëveshje ndër komunale me komunat tjera, si fjala vjen me Komunën e Vitisë, për ndonjë projekt të fshatit Kërbliq. Fshati Kërbliq është me i izoluar ndër të gjitha fshatrat të tjera të komunës tonë, kështu që përmes ndonjë granti apo MTI është mirë me bërë diçka në këtë drejtim në bashkëpunim me Komunën e Vitisë, për ndonjë projekt që ndikon në zhvillimin e këtij fshati.

Kryetari i Komunës, Ne kemi insistuar në këtë drejtim, por kjo ka qenë mosgatishmëri e MTI me ndërtuar një rrugë ku nuk ka banorë.

z. Selim Reka, Është mirë në të ardhmen komuna e jonë me lidhë marrëveshje edhe me ndonjë komunë tjetër për ndonjë projekt, si fjala vjen me Komunën e Vitisë, sepse me këtë komunë lidhen shumë fshatra të komunës tonë, pse jo edhe për zhvillimin e turizmit. Ne LDK-a do të jemi Për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës, të përcaktuar si në Propozim Vendim.

Kryesuesi i Kuvendit, Është hera e parë që ndahet fond për bashkëpunim ndër komunal, ndërkaq ne duhet të qartësohem se, a jemi për këtë fond apo nuk jemi ?

z. Ekrem Raka, Komuna e Kaçanikut duhet me pas bashkëpunim ndër komunal edhe me ndonjë komunë tjetër siç është Ferizaj apo me ndonjë komunë tjetër, për ndonjë projekt zhvillimor që është në interes të dy komunave.

z. Besim Vishi, Cila është arsyja e ndërtimit të rrugës, a ka me shërbyer për turizëm apo diç tjetër realizimi i këtij projekti?

z. Nexhat Loku, Unë pasi jam nga ajo anë, e njoh mirë atë terren. Rruga e cila ka me u ndërtuar, është rrugë ekzistuese dhe e njëjtë ka me u zgjeruar nga dy anët.

z. Ramadush Osmani, Kjo Nismë është për një projekt të caktuar, ndërkaq kjo nuk na pengon në të ardhmen për me lidhur marrëveshje të tjera ndër komunale me komunat tjera, por tanë për tanë afati për donacione ka kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me një votë Abstenim, atë të Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal të Komunës së Kaçanikut me Komunën e Hanit të Elezit, për realizimin e Projektit për rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës, nga fshati Gorancë deri në fshatin Kotlinë.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:30 Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfise Malsiu
M. Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli


REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);

**nga Mbledhja e IV (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për
vitin 2019, mbajtur me 30.04.2019.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

DATË/A:	20.05.2019
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Delegatët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Loku, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarit <i>Fatmir</i> .
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigj-je në pyetjen e deputetit z. Adnan Reka lidhur me Frizin që është përfitus prej MBZHRP

Përgjigj-je në pyetjen e bërë nga z. Adnan Reka deputet i Kuvendit Komunal.

Fermeri Zylbehar Latif Lika me nr, NIF 1027656 ka të kultivuar 5 ha me mqedër dhe ka përfituar një grand nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Nga ky grand ky fermer ka rregulluar depon për ruajtjen e fruteve të mjedrës .

Ne kemi qen në teren për të vlerësuar gjendjen teknike të këtij frizi dhe u konstatua se ishte i dëmtuar .

Por ky friz ishte donacion nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë dhe fermeri i lartëcekur ishte përfitues individual me participim nga vetë fermeri.

Ne si drejtori ndihemi keq per dëmtimin e këtij aseti por ky aset menaxhohet nga Axbencioni për Zhvillimin e Bujqësisë në periudhë 5 vjeçare nga momenti i nënshkrimit të kontratës mes palëve të lartëkura.



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 28. 05. 2019

Për: Anëtarët e Kuvendit: znj. Kaltrina Tafili,
z. Bekim Koxha
z. Selim Reka
z. Shpend Krusha,

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjëm dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 30. 04. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

znj. Kaltrina Tafili, Në Lagjen Teneq të f. Stagovë, kërkoj të bëhet rregullimi i rrjetit të energjisë elektrike, sepse për shkak të defekteve në rrjetë, qytetarëve të kësaj lagjeje po iu shkatërrohen pajisjet elektrike të amvisërisë. Gjithashtu në këtë lagje mungojnë; Asfaltimi dhe Ndriçimi publik.

- *Qështja e rregullimit të rrjetit të rrymës elektrike në lagjet e qytetit dhe fshatrave është në kuadër të planifikimeve për investime kapitale të KEDS-it. Ne si drejtori në vazhdimësi ju përcjellim shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve lidhur me rrjetin dhe tensionin e dobët të energjisë elektrike dhe me këtë rast e kemi njoftuar edhe për rastin e lagjes Teneqja-Stagovë. Sipas kompanisë është dorëzuar projekt-propozimi dhe po pritet aprovimi nga selia qendrore në Prishtinë.*
- *Rreth asfaltimit të rrugës të kësaj lagjeje, do të shqyrtojmë mundësitet që në kuadër të projektit "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale" të mundësohet rregullimi i kësaj rruge kurse në planifikimet për ndriçim publik, jemi duke vazhduar me rrugët primare të fshatrave dhe lagjeve të qytetit.*

z. Bekim koxha; Më intereson të di, Përse nuk janë bërë ende kyçjet në rrjetin e ujësjellësit të f. Koxhaj.

- *Projekti "Sanimi, rekonstrumi dhe shtimi i kapaciteteve ujore për rrjetin e ujësjellësit Dubravë-Doganj-Elezaj-Rekë-Nikaj –K. Vjetër", projekt që financohet dhe mbikëqyret nga MMPH-ja, është në fazën përfundimtare. Aktualisht janë duke u bërë montimi i orëve dhe testim i rrjeteve shpërndarëse në të gjithë lokalitetet e planifikuara.*

z. Selim Reka; E kam një Kërkesë të qytetarëve të Kaçanikut, që komuna me ndaluar ndërtimin në zonat e hapësirave gjelbëruese në qytet.

2.Në Rrugën, "Asim Vokshi" kanë ngelë 100m rrugë pa u asfaltuar. Është mirë që të asfaltohet sipërfaqja e mbetur e rrugës, kur dihet së me këtë rrugë lidhet rruga të Axhamët dhe të Senatoriumi.


- *Shfrytëzimi i hapësirave publike për qëllime biznesi apo reklamimi jepet me afat të përkohshëm. Në momentin kur nga drejtoria vlerësohet se një aktivitet i tillë është pengesë në hapësirën e caktuar apo pala nuk përfillë kushtet e pëlqimit, atëherë nuk i vazhdohet leja për shfrytëzim të hapësirës publike.*
- *Rreth asfaltimit pjesës së mbetur të rrugës "Asim Vokshi", do të shqyrtojmë mundësitet që në kuadër të projektit "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale" të mundësohet rregullimi i këtij segmenti rrugor.*

z. Shpend Krusha, Në Lagjen Imishti, në rrugën "Ilirët", shtyllat e energjisë elektrike janë vendosur të betonit, ndërkaq nuk janë hequr shtyllat drurit të cilat kanë ekzistuar më herët. Unë nuk e di a paraqesin rrezik shtyllat e drurit të cilat nuk janë hequr.

- *Edhe për rastin e shtyllave të betonit të energjisë elektrike në lagjen Imishti është kontaktuar kompania përgjegjëse KEDS-njësia në Kaçanik dhe kemi kërkuar që të finalizoj projektin e caktuar dhe largimin e shtyllave ekzistuese. Sipas kompanisë pritet shumë shpejt vendosja e një ormani shpërndarës dhe rregullimi i kyqjeve familjare në këtë rrjet.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-së



Për: z. Adnan Reka, anëtar i kuvendit;

Lënda: Sqarim.

I nderuar,

Gjatë mbledhjes së kuvendit të kaluar, në diskutim e sipër kritikuat se si Komuna e Kaçanikut krijon të hyra nga fotokopjimi i dokumenteve duke iu referuar raportit tre-mujorësh.

Në shikim të parë çdokush do të duhej të ishte kritik nëse institucionet tona publike krijojnë të hyra nga fotokopjet të cilat nuk janë të planifikuara, si dhe nuk janë fare të precizuara në rregulloren për taksa dhe tarifa komunale. Sidoqoftë, lëshimi ynë është tek përshkrimi i cili ka ndodhur në raport.

E vërteta është që ne asnjëherë nuk i obligojmë qytetaret të paguajnë për fotokopjimin e dokumenteve, përkundrazi, ne këto shërbime edhe pse nuk jemi të obliguar t'i kryejmë, i fotokopjojmë falas!

Fakti qëndron se në kuadër të drejtorisë të Administratës së Përgjithshme funksionon sektori i arkivit dhe kur palët kanë kërkesë zyrtare për gjetjen e lëndëve arkivore, atëherë janë të obliguar qe të paguajnë për marrjen e dokumenteve kopje nga arkiva me çmim prej 10 cent/A4! (për me shumë shih nin 6 të rregullores 01/2016 për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve tjera komunale)

Në këtë rast përshkrimi i saktë do të duhej të ishte “Tarifa nga sektori i arkivit” ku përfshihen të gjitha shërbimet që ofron ky sektor.

Ju faleminderit!

Me respekt,

Drejtore i DAP

Festim Neziraj

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kaçanik;
Tel. 038 200-46429; e-mail: festim.neziraj@rks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Për :Kemal Murseli,Kryesues I Kuvendit të Komunës
Antarëve të Kuvendit/ **z. Ekrem Kyçyku ,z. Adnan Reka**
Lënda:përgjigje

z. Ekrem Kyçyku : Në një Konkurs punësimi të shpallur në QKMF, është kërkuar që kandidatët të cilët kanë aplikuar të pajisen me Certifikatë shëndetësorë. Nuk e di a është e ligjshme me ua kërkuar certifikatën shëndetësore, sepse është e kushtueshme (20-25€) për kandidatët të cilët kanë aplikuar për me marrë pjesë në një konkurs.

Në secilin konkurs për punësim është rregullore dhe kërkohet certifikata shëndetësore,kurse ajo kushton 15€ .Arsyeja është se kandidati kryen konsultë mjeksore ,egzaminim mjekosorë,I bënë analizat e gjakut, rentgenin dhe në fund I lëshohet certifikata mjekësore për punsim për të dëshmuan se kandidati është I aftë në pikëpamje psiko-fizike për punë.

z. Adnan Reka :Tani nga Ekrem Kyçyku e kuptova, pse drejtoria e Shëndetësisë paska arkëtuar 1730€ vetëm për 3 muaj nga taksa për, Certifikata mjekësore, sepse po shitkan certifikata mjekësore pa u kontrolluar fare nga mjekë përkatës. 100 aplikues që kanë paguar nga 15€ për certifikata mjekësore në “Konkursin për mami” që ishte para disa javësh, paskan paguar 1500€

dhe konkursi është anuluar. Qenka mirë t'i përsërisni konkurset sa më shpesh që komuna të realizoni sa më shumë para nga të HV.

Certifikatat nuk shiten ,por kandidatët egzaminohen kryejnë analizat e nevojshme dhe pas gjitha këtyre procedurave leshohet qertifikata shëndetësore , ky është rregull nuk e kemi shpikur ne. Nenuk do të shkelim ligjin ,duke mos ju kërkuar qertifikatë shëndetësore kandidatëve ,se është rregull, kurse sa l përket anulimit të konkursit njoftimi ka qen publikuar janë dhënë arsyet e anulimit.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

Me respekt





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

PËRGJIGJE

Për anëtaren e Kuvendit të Komunës, znj.Fatjona Kyqyku

zpj. Fatijona Kyçyku, Kur do të filloj realizimi i projektit të ndërtimit të Qarshisë së qytetit të Kaçanikut ? Nëse ky projekt nuk ka filluar ende, Kërkesa ime është që të fillohet sivjet me realizimin e këtij projekti.

Ne DUKMM, kemi planin e vjetër për zonën e Qarshisë së qytetit. Gjithashtu kemi mbajtur një debat publik me qytetarë, ku kemi marrë sugjerimet e tyre rreth dukjeve të qarshisë dhe funksionimit të saj. Kemi ardhur në përfundim që të bëjmë një revidim të planit të vjetër të qarshisë së vjetër, duke marrë parasysh edhe rekondimet e Planit Zhvillimor Komunal në atë zonë.

Me respekt !

Ukshin Çallaku
Drejtor i DUKMM